Numër: 01/152
Datë: 19.03.2024

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke vendosur sipas ankesës Nr. 01/74 e parashtruar me datë 21.02.2024 nga Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" e përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" me adresë: Rr. "Holger Peterson" Objekti "Park Rezidenc" Hyrja 4, Kati 0, Nr. 2, në Prishtinë, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr. 01/28 të datës 26.01.2024, në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 8 i Rregullores Nr. 01/196 të punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 15.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" Nr. 01/74 e datës 21.02.2024, e ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/28 të datës 26.01.2024.

2. Mbetet në fuqi vendimi Nr. 01/28, i datës 26.01.2024 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" me datë 14.04.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të institucionit me kualifikimin: Asistent me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, niveli V sipas KKK, e cila në AKK është protokoluar dhe ka marrë numër 01/172. Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka nxjerr vendimin Nr. 01/28 me të cilin ka refuzuar akreditimin dhe validimin e Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" për Kualifikimin Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, Niveli V sipas KKK.

Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" i pakënaqur me vendim e Këshillit Drejtues Nr. 01/28 të datës 26.01.2024, me datë 21.02.2024 brenda afatit ligjor nga pranimi i vendimit, përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" ka parashtruar ankesë pranë Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve e cila është protokolluar dhe ka marrë Nr. 01/74, me pretendimet e shkeljes së dispozitave ligjore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli Drejtues pasi ka pranuar ankesën nga pala ankuese ka vendosur që përmes Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) t`i dërgoj ekipit vlerësues të ekspertëve ankesën e institucionit për të dhënë mendimet e tyre profesionale, bazuar në obligimet që kanë ekspertët sipas marrëveshjes së lidhur me AKK-në, që në raste të parashtrimit të ankesës kundër vendimit të KD të AKK-së, të përgjigjen në kërkesat e AKK-së në dhënien e mendimit profesional për kualifikimin për të cilin kanë përgatitur raportin e akreditimit dhe validimit. Pas kërkesës së Këshillit Drejtues AKK me datë 07.03.2024 përmes zyrtares së saj ka dërguar email tek ekipi i ekspertëve dhe ka kërkuar mendimin e tyre profesional rreth pretendimeve të palës ankuese si në ankesë.
Ekipi i ekspertëve vlerësues bazuar në kërkesën e Këshillit Drejtues me datë 12.03.2024 ka përpiluar një përgjigje në ankesën e institucionit "Qendra profesionale për Gjithëpërfshirje", e cila në AKK është protokolluar dhe ka marrë Nr.01/140.

Këshilli Drejtues i AKK-së shqyrtoj pretendimet ankimore të palës ankuese të parashtruara kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/28, të datës 26.01.2024

Në përgjigjen e dhënë ekspertët kanë theksuar se: Ankesa e parashtruar nga Institucioni është një përsëritje me vlerësime, mendime personale, një pjesë e të cilave edhe të pavërteta, joprofesionale dhe jo kolegiale, e sipas tyre fatkeqësisht edhe shpifje. Ekipi vlerësues ka theksuar faktin se mendimin tonë profesional lidhur me aplikantin e kemi paraqitur në raportin tonë me të gjitha argumentet, prandaj nuk do të përsërisim asnjë gjë, pasi qëndrojmë tërësisht prapa këtij vlerësimi.

Pala ankuese pretendon se procesi vlerësues në këtë institucion nuk është kryer në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Këshilli Drejtues i AKK- së konstatoj se ky pretendim i palës ankuese nuk qëndron për faktin se procesi lidhur me akreditimin e institucioneve dhe validimin e kualifikimeve nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve realizohet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së. Pala ankuese pretendon se ekipi vlerësues i eksperteve pas përpilimit të draft raporteve preliminare i ka dërguar draft raportet "Qendrës Profesionale për Gjithëpërfshirje" duke i kërkuar në mënyrë të kundërligjshme përmbushjen e kushteve dhe rekomandimeve në draft raportet vlerësuese brenda afatit prej pesë (5) ditëve. Lidhur me këtë pretendim ekipi i ekspertëve në përgjigjen mbi ankesën e palës ankuese thekson se: EEV nuk i ka dhën afat 5 ditë as më shumë e as më pak aplikuesit, pasi nuk ka qenë kompetencë e tyre. Prandaj, ankesat e tyre në ekipin vlerësues nuk qëndrojnë.

Pretendimet e palës ankuese se ekipi i ekspertëve ka shkelur dispozitat procedurale, konkretisht nenin 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, janë të pa bazuara sepse neni 16 paragrafi 4 i këtij udhëzimi përcakton mënyrën e njoftimit të palës aplikues me draft raportet e eksperteve, të drejtën e aplikuesit për të paraqitur vërejtje dhe komente për draft raportet si dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të dorëzohen në AKK. Ekipi i ekspertëve në asnjë formë nuk ka kërkuar që kushtet dhe rekomandimet të përmbushen brenda

afatit prej pesë ditësh siç pretendon pala ankuese, ndërsa bazuar në dispozitat ligjore në fuqi AKK i ka dërguar aplikuesit draft raportet preliminare për të cilat aplikuesi kishte të drejtën të paraqes vërejtje dhe komente lidhur me draft raportet e përpiluara nga ekipi i eksperteve.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve lidhur me pretendimin e palës ankuese se Ekipi i eksperteve vlerësues (EEV) nuk ka marrë për bazë Përgjigjen e "Qendrës Profesionale për Gjithëpërfshirje" të datës 06.12.2023 si dhe pas analizimit të përgjigjes së ekipit të ekspertëve mbi ankesën e palës ankuese, gjeti se ekipi i ekspertëve nuk e ka parë të nevojshme ta ndërroj raportin për shkak se nuk ka pasur asnjë informatë që do ta bënte ekipin për të ndryshuar raportin. Prandaj, pretendimi i palës ankuese se ekipi i ekspertëve ka shkelur paragrafin 5 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nuk qëndron, sepse kjo dispozitë ligjore nuk obligon EEV të ndryshoj raportet në bazë të vërejtjeve dhe komenteve të aplikuesit.

Pala ankuese pretendon se i është mohuar e drejta për tu informuar lidhur me procesin e vlerësimit nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), duke theksuar faktin se raportet përfundimtare të ekspertëve i ka marrë vetëm pas parashtrimit të kërkesës për qasje në dokumente publike. Këshilli Drejtues i AKK-së konstatoj se bazuar në nenin 21 paragrafi 2 AKK publikon në faqen e saj të internetit, vendimet e KD të AKK dhe raportet vlerësuese të ekspertëve, por vetëm pasi që janë shqyrtuar ankesat eventuale kundër vendimeve të nxjerra. Po ashtu, vetë fakti se AKK i ka dërguar draft raportet për vërejtje dhe komente shtesë aplikuesit dhe fakti se AKK ka nxjerr vendim nr. 02/34 dhe i ka lejuar qasjen në raportet përfundimtare të ekipit vlerësues, si dhe në çdo kohë e ka njoftuar aplikuesin për ecurinë e procesit, është mjaft e qart se procesi ka qenë i drejtë dhe transparent, andaj, edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Pala ankuese në ankesën e saj pretendon se Ekipi i eksperteve gjatë vizitës së realizuar në Institucionin "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" ka pasur sjellje ofenduese, përfshirë raste të seksizmit dhe diskriminimit gjinor të anëtarëve të stigmatizuar. Duke pretenduar se EEV nuk ka qenë objektiv dhe profesional gjatë vlerësimit të QPGJ-së. Ekipi i eksperteve në deklarimet e dhëna në përgjigjen mbi ankesën e QPGJ-së pretendimet e tilla i konsideron shpifje dhe të pavërteta. Këshilli Drejtues i AKK-së pasi analizoj pretendimet ankimore dhe përgjigjen e eksperteve lidhur me këto pretendime konstatoj se nuk ka asnjë provë me të cilën vërtetohen pretendimet e palës ankuese dhe pala ankuese këto pretendime i ka ngritur vetëm pas marrjes së vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr. 01/28 të datës 26.01.2024, me të cilin i është refuzuar akreditimi dhe validimi. Pala ankuese ngrit pretendime të tilla pasi kanë kaluar më shumë se tre muaj nga realizimi i vizitës së ekipit të ekspertëve në këtë institucion datë 08.11.2023 dhe pretendimet e tilla nuk i ka provuar me asnjë provë.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese se Këshilli Drejtues i AKK-së ka tejkaluar kompetencat ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr.01/28 sepse nuk përkon fare me rekomandimet e ekipit vlerësues të eksperteve, madje është në kundërshtim të plotë me këto rekomandim, me pretendimin se është shkelur neni 17 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Këshilli Drejtues këtë pretendim e konsideron të pa bazuar sepse nga të gjeturat në raportet përfundimtare të ekipit të eksperteve, si dhe tani në përgjigjen e ekipit vlerësues të eksperteve në ankesë është dëshmuar se vërtetë institucioni nuk përmbush kushtet dhe kriteret për akreditim dhe validim, ku në pikën 8 të përgjigjes ekipi vlerësues thekson se : sygjerimi i institucioni për të angazhuar ekspert ka qenë mënyrë e moderuar për t'ju thënë se plani i biznesit i

dorëzuar është jo serioz dhe se aplikuesi ka nevojë për një plan të vërtetë biznesi. Plani i prezantuar sipas eksperteve është amator, jo real, joprofesional, ashtu siç është gjithë organizimi i kësaj ndërmarrje biznesore. Po ashtu EEV i ka rekomanduar institucioni që edhe CV të bëhën në mënyrë profesionale, pasi janë të dobëta me përshkrime amatore dhe më të pavërteta. Ekipi i ekspertëve ka mohuar pretendimet e palës ankuese se të njëjtit ju kanë drejtuar mësimdhënësve me pyetjen: Allahile sa i keni rrogat? A ju kanë paguar Natyra dhe Erebliri? Ekipi i eksperteve ka deklaruar se fatkeqësisht ashtu si një pjesë e madhe e dokumentacionit që kemi analizuar edhe këto paga janë të rrejshme dhe të pa vërteta, janë dokumente sa për ti hedhur sy ekspertëve dhe AKK-së.

Pala ankuese pretendon se konstatimi i Këshillit Drejtues se kriteri lidhur me modulet mësimore nuk përmbushe është i pa qëndrueshëm, lidhur me këtë pikë Këshilli Drejtues vërtetoj këtë gjendje faktike: ekipi i eksperteve edhe në raportet vlerësuese përfundimtare, e po ashtu edhe në përgjigjen në ankesën e palës ankuese ka theksuar se: Institucioni/pala ankuese ka bashkangjitur aneksin 1 plan programi e modulit 1 nga Pearson që ka 84 faqe për 24 njësi mësimore dhe punën që do bëhet, kurse aneksi 2 plan programi i QPGJ me 4 faqe pa asnjë shpjegim për asnjë nga njësit mësimore, përmbajtjen e tyre dhe si do të zhvillohen ato. Pala ankuese pretendon se këto i ka përmbushur në përgjigjen e datës 06.12.2023, mirëpo, ekipi i eksperteve në përgjigjen e dhënë me datë 12.03.2024 ka theksuar faktin se edhe pas përgjigjes së QPGJ nuk e ka parë të nevojshme ta ndërroj raportin, për shkak që sipas tyre nuk ka pasur asnjë informatë që do ta bënte ekipin për ta ndryshuar raportin.

Andaj, bazuar në neni 8 paragrafi 1 pika 1.4 Institucionet ofruese apo vlerësuese duhet ti përmbushin kriteret e akreditimit. Mos përmbushja e obligimeve do të rezultojë me refuzim të akreditimit. Kështu pretendimi i palës ankuese se Këshilli Drejtues i AKK-së ka vepruar kundërligjshëm me rastin e refuzimit të akreditimit të palës ankuese nuk qëndron dhe është tërësisht i pa bazuar, Këshilli Drejtues është organ kolegjial vendimmarrës dhe bazuar në Rregulloren nr. 01/196 të dt. 25.05.2021 ka përgjegjësi të plotë në zhvillimin e politikave dhe vendimmarrjen e proceseve të ndërlidhura me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor në këtë çështje administroj këto prova:

- Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 01/28 i marrë me datë 26.01.2024;
- Ankesën e Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" të parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" me datë 21.02.2024 dhe të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë;
- Raportet vlerësuese të ekipit të eksperteve për akreditim dhe validim të Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" për kualifikimin: Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, niveli 5 i KKK;
- Përgjigjet e QPGJ për EEV të datës 06.12.2023;
- Emalin e zyrtares së AKK-së të datës 07.03.2024 drejtuar ekipit të ekspertëve për dhënien e vlerësimit profesional lidhur me ankesën Nr.01/74 e dt. 21.02.2024 e ushtruar nga Institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata".

- Përgjigjen e ekipit të ekspertëve në ankesën e institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" nr. 01/140 të datës 1203.2024.

Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e vendosjes në ankesë është mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren e Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/196 e dt. 25.05.2021, si dhe në Ligjin për Procedurën e përgjithshme Administrative.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve pasi shqyrtoj dhe analizoj ankesën e Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje", raportet vlerësuese përfundimtare të ekipit të eksperteve, përgjigjen e eksperteve Nr. 01/140 të datës 12.03.2024 lidhur me ankesën e palës ankuese, pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga institucioni "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje" përmes përfaqësuesit të autorizuar është e pa bazuar.

Andaj, mbi të lartcekurat Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Qendra Profesionale për Gjithëpërfshirje"
2. Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata"
3. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së